



## Deklaratë

Kampanja **Vota Ime ka Vlerë** organizohet nga Rrjeti KOSINT 2020, i cili është rrjet i organizatave të shoqërisë civile që punojnë për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë e Kosovës.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët janë qytetarë të këtij vendi dhe kërkojnë të marrin pjesë aktive në proceset demokratike dhe vendimmarrëse. Shumë politikanë kanë premtuar se jeta e komuniteteve do të përmirësohet, por ende nuk shohim rezultate të dukshme. Nga sondazhet që lidhen me zgjedhjet dhe pjesëmarrjen e katyre komuniteteve, mund të shihet se mbi 30% e të anketuarve kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit parlamentare me 2017.

Kjo kampanjë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit 2019 synon:

- 1. të inkurajojë votuesit rom, ashkali dhe egjiptian të marrin pjesë në zgjedhje dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes;**
- 2. të merr zotimin e kandidatëve për deputet për plotësimin e kërkesave të cilat do të ndikojnë në mirëqenien e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.**

Me pjesëmarrje në zgjedhje, komunitetet rrisin mundësinë të realizojnë interesat e tyre kolektive, të cilat njëherit do të jenë pjesë e kërkesave të tyre për partitë politike në përgjithësi dhe kandidatëve për deputet në veçanti.

Duke u zotuar për plotësimin e këtyre kërkesave deputetët e ardhshëm dëshmojnë gatishmërinë e tyre për të punuar për të mirën e të gjithë qytetarëve, dhe të jenë zëri i tyre në Kuvendin e Kosovës.

Pas konsultimit me qytetarët rom, ashkali dhe egjiptian, për të rritur përfshirjen e tyre në rrjedhat sociale dhe në të njëjtën kohë garantimin e suksesit të shtetit në të ardhmen, kampanja Vota Ime ka Vlerë synon artikullimin e zërit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe njëherit kërkon:

- Rritjetë shkallës së punësimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik, lokal dhe qendror, të paktën deri 10% dhe atë në shkallë proporcionale të pjesëmarrjes së tyre në popullsinë e përgjithshme, që duhet të arrihet deri në vitin 2022;**
- Rritje të nivelit të regjistrimit dhe përfundimit të arsimit fillor (90%) dhe sekondar (50%) të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian deri me 2022;**
- Ndarjetë buxhetit me kode specifike lokale dhe qendrore për adresimin e problemeve dhe prioritetëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian deri në vitin 2022.**

Me nënshkrimin tim unë i bashkohem Kampanjës Vota Ime ka Vlerë.

Emri dhe mbiemri

Komuna

Telefoni

Nënshkrimi

---